

Lidhur me çertifikimin e personelit që përdor pajisje/instalime nën presion.

Punonjësit që do të duhet të regjistrohen pranë shoqërisë SWISS APPROVAL ALBANIA për t'u çertifikuar në përdorimin e pajisjeve nën presion në fushat për të cilat është akredituar SWISS APPROVAL ALBANIA duhet të paraqesin:

Dokumentacioni Administrativ:

(Është i domosdoshëm për fillimin e procedurave administrative të rregjistrimit të aplikantit)

1- Kërkesë me shkrim e Punëdhënësit (drejtuar shoqërisë SWISS APPROVAL ALBANIA) ku të përcaktohet qartë fusha e kërkuar për çertifikimin e punonjësit, sipas kategorizimeve sa më poshtë:

Grupi	Përshkrimi i fushës
A.	Operues të rezervuarëve nën 13 m ³ me GLN.
B.	Operues të rezervuarëve mbi 13 m ³ me GLN.
C.	Operues të enëve nën presion të instalimeve teknologjike dhe rezervuarve të ajrit.
D.	Operues të kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë.
E.	Operues të enëve nën presion kriogjenike.
F.	Operues të pajisjeve të qëndrave të mbushjes të bombolave me GLN.
G.	Operues të transvazimit (ngarkim/shkarkimit) të çisternave auto/hekurudhore.
H.	Operator të bombolave me GLN, për transportin me automjete me peshë maksimale nën 3,5 ton.

- 2- Dokument vërtetues nga punëdhënësi se ka kryer kursin e trajnimit përkatës të miratuar nga punëdhënësi, është familjarizuar me parimet dhe praktikën e përdorimit të pajisjes/pajisjeve nën presion dhe ka fituar përvojën e kërkuar nën mbikqyrjen e kualifikuar;
- 3- Formulari i Aplikimit i firmosur nga Aplikanti (bashkëlidhur më poshtë);
- 4- Fotokopje e kartës së identitetit;
- 5- Diploma/dëftesa e edukimit arsimor 8 / 9 ose 12 vjeçar e Aplikantit (fotokopje);
- 6- Vërtetim që është i aftë për punë, lëshuar nga autoriteti shëndetësor publik;
(lëshuar brenda 1 viti nga data e aplikimit)
- 7- Dy fotografi të kohëve të fundit, 4,5 cm x 3,5 cm (prapa fotove të shënohet emri dhe mbiemri);
- 8- Dokumentin bankar për pagesën e tarifës përkatëse të çertifikimit të punonjësit, në adresë të SWISS APPROVAL ALBANIA;

Dokumentacioni Teknik:

(Është i domosdoshëm për procedurat e testimit dhe vlerësimit të aplikantit, i fokusuar në ekzaminimin praktik të pajisjes/instalimit nën presion për të cilën kërkohet çertifikimi)

Kërkesa me shkrim e Punëdhënësit duhet të përmbajë të dhënat teknike të plota të pajisjes/instalimit për të cilën kërkohet çertifikimi i përdorimit/shfrytëzimit dhe bashkëlidhur dokumentacionin teknik sa më poshtë:

- 9- Skema teknologjike e funksionimit të pajisjes/ instalimit nën presion;
- 10- Instruksioni/rregullorja e shkruar e përdorimit/shfrytëzimit të pajisjes/instalimit nën presion, e miratuar nga punëdhënësi përbën dhe 1/3 e vlerësimit total të testimit të punonjësit;

Plotësimi i dokumentacionit sa më sipër i referohet kërkesave të dokumenteve të SWISS APPROVAL ALBANIA: OCEB 10 02, Procedurat për regjistrimet, Pika 2;

OCEB 08 01, Metodologjia e çertifikimit të personelit të shfrytëzimit të pajisjeve nën presion, Pika 3.2

- *Pa plotësimin e dokumentacionit administrativ dhe teknik sa më sipër nuk mund të procedohet për testimin dhe vlerësimin e aplikantëve.*
- *Aplikanti ka të drejtë të marrë pjesë në dy teste (për vleftën e shlyer të shërbimit). Në rast vlerësimi negativ, në të dy testet, aplikimi bëhet i pavlefshëm dhe duhet kryer aplikim i ri bashkë me pagesën e shërbimit.*

